

**VENDIM**  
**Nr. 407, datë 8.5.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E NJË REGJIMI KONTROLLI PËR TË GARANTUAR RESPEKTIMIN E  
RREGULLAVE TË POLITIKAVE MENAXHUESE NË PESHKIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 72, pika 8, 74, pika 4, 77, pika 3, 82, pika 2, 101, pika 2, 112, pika 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, dhe 135, pika 1 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

TË PËRGJITHSHME

1. Ngritjen e një sistemi kontrolli, inspektimi dhe zbatimi, në kuptim të këtij vendimi “regjimi i kontrollit”, për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim.

2. Regjim kontrolli, në kuptimin e këtij vendimi, është tërësia e masave dhe aktiviteteve që do të ndërmerren për një shfrytëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm të burimeve peshkore të ujërave detare dhe ujërave të brendshme nëpërmjet sistemit të monitorimit dhe mbikëqyrjes, inspektimit dhe kontrollit të kryer nga nëpunësit përkatës, për të verifikuar zbatimin e rregullave të peshkimit, pasqyrimin e këtij kontrolli në raportet përkatëse, regjistrimin e të dhënave në librat e anijes apo në format elektronik, identifikimin e lëvizjes së anijeve dhe komunikimin elektronik të tyre, sigurimin dhe transmetimin e të dhënave, rregullimin e kapacitetit të peshkimit, procedurat për shitjen e parë të produkteve të peshkimit, skemën e certifikimit të zënieve për eksportimin dhe importimin e produkteve peshkore dhe autoritetet përgjegjëse për kontrollin e tyre.

Ky përfshin të gjitha aktivitetet që kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga anijet shqiptare të peshkimit ose nga shtetasit shqiptarë.

3. Ky vendim nuk zbatohet në rastet e dispozitave të veçanta të parashikuara nga marrëveshjet e peshkimit të lidhura apo të zbatueshme në kuadër të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Republika e Shqipërisë është palë kontraktuese apo palë bashkëpunuese jokontraktuese.

4. Inspektorët për peshkimin monitorojnë veprimtaritë e anijeve shqiptare të peshkimit, që ushtrohen jashtë zonës së sovranitetit ose juridiksionit të peshkimit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ky kontroll është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e ligjshmërisë në këto ujëra.

5. Ministria merr masat e duhura, duke vënë në dispozicion burime financiare, njerëzore e teknike dhe krijimin e strukturave teknike-administrative të nevojshme për të siguruar kontrollin, inspektimin dhe ekzekutimin e aktiviteteve të ushtruara në kuadër të politikës shqiptare të peshkimit. Ministria vendos në dispozicion të inspektorëve për peshkimin, në kuadër të Drejtorisë së Kontrollit për Mjedisin, të gjitha mjetet e nevojshme për të kryer detyrat e mësipërme.

6. Inspektorët për peshkimin marrin masat e duhura në mënyrë që kontrolli, inspektimi dhe zbatimi i normave të kryhen në mënyrë jodiskriminuese, për sa u përket sektorëve, anijeve të peshkimit apo personave, mbi bazën e menaxhimit të rrezikut.

KREU II

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR HYRJEN NË UJËRAT DHE NË BURIMET

7. Informacioni që përmban leja e peshkimit duhet të jetë në përputhje me informacionin e numrit të regjistrit të anijeve të peshkimit (RAP) dhe me kërkesat e tjera, të përcaktuara në shtojcën 1 të këtij vendimi.

8. Ministria pezullon lejen e peshkimit për një anije peshkimi, në rastin e ndalimit biologjik ose në rastet e parashikuara nga nenet 129 dhe 130 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”.

9. Ministria tërheq përfundimisht lejen e peshkimit për një anije peshkimi, kur kjo e fundit është subjekt i rasteve të parashikuara nga nenet 129 dhe 130 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”.

10. Në rastin e pezullimit ose tërheqjes përfundimtare të lejes së peshkimit për një anije peshkimi, ministria njofton menjëherë titullarin e lejes së peshkimit në fjalë.

11. Në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, informacioni që përmban autorizimi i peshkimit duhet të jetë në përputhje me informacionin e parashikuar në shtojcën 2 të këtij vendimi.

12. Autorizimi i peshkimit nuk lëshohet nëse anija në fjalë nuk zotëron lejen e peshkimit të marrë në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, ose nëse leja e saj e peshkimit është pezulluar apo hequr.

13. Autorizimi i peshkimit tërhiqet automatikisht nga ministria, nëse leja e peshkimit të anijes është hequr në mënyrë përfundimtare gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit.

14. Autorizimi i peshkimit pezullohet për aq kohë sa është pezulluar dhe leja e peshkimit.

### KREU III

#### SHËNJIMI DHE IDENTIFIKIMI I ANIJEVE E MJETEVE TË PESHKIMIT

15. Anijet e peshkimit shënjohen si më poshtë:

a) Shkronjat e emrit të portit në të cilin anija e peshkimit është regjistruar dhe numrat e regjistrimit shkruhen me bojë në të dyja krahët në bashin e anijes, sa më lart që të jetë e mundur nga vija e ujit, në mënyrë që të jenë qartësisht të dallueshme nga deti dhe uji, me një ngjyrë në kontrast me sfondin në të cilin janë shkruar;

b) Për anijet e peshkimit me gjatësi më të madhe se 10 metra, por më të vogël se 17 metra, lartësia e shkronjave dhe numrave duhet të jetë, së paku, 25 cm, kurse trashësia e vijës 4 cm. Për anijet e peshkimit me gjatësi më të madhe se 17 metra, gjatësia e shkronjave dhe numrave duhet të jetë, së paku, 45 cm dhe trashësia e vijave 6 cm;

c) Sinjali radio i thirrjes ndërkombëtare (IRCS) ose shkronjat dhe numrat e regjistrimit të jashtëm pikturohen, gjithashtu, në mënyrë të qartë, në kontrast me sfondin në të cilin janë shkruar, në majë të kabinës së timonerisë dhe në mënyrë që të jenë qartësisht të dukshme nga qielli;

ç) Ngjyrat me kontrast janë e bardha dhe e zeza;

d) Shkronjat dhe numrat e regjistrimit të jashtëm, të shkruar ose treguar mbi skafin e anijes së peshkimit, nuk duhet të hiqen, të fshihen, të ndryshohen, të bëhen të palexueshme, të mbulohen ose të maskohen.

16. Kapitani i një anijeje peshkimi me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 10 metra mban në bordin e anijes dokumentacionin e lëshuar nga kapiteneria e portit dhe shoqëria klasifikuese në të cilën anija është regjistruar. Dokumentacioni në fjalë përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e anijes;

b) shkronjat e portit në të cilin anija është regjistruar dhe numrat e regjistrimit;

c) sinjalin eventual ndërkombëtar të thirrjes;

ç) emrin dhe adresën e pronarit/pronarëve dhe ose marrësve në përdorim;

d) gjatësinë totale, fuqinë motorike shtytëse, tonazhin bruto dhe, për anijet e hyra në peshkim pas 1 janarit 2011 e më pas, datën e hyrjes në peshkim.

17. Kapitani i një anijeje peshkimi me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 17 metra, të pajisur me frigoriferë, mban në bord disenjo të sakta dhe përshkrimin e tyre, përfshirë edhe pikat e hyrjes dhe kapacitetin neto të shprehur në metër kub.

18. Kapitani i një anijeje peshkimi të pajisur me depozita uji të flohtë deti mban në bord një dokument të përditësuar, në të cilin tregohet kapaciteti i depozitave, i shprehur në metra kub, me intervale prej 10 cm.

19. Dokumentet e përmendura në pikat 16 e 17 të këtij vendimi, certifikohen nga Kapiteneria e Porteve. Çdo modifikim i mundshëm i bërë në karakteristikat që përmbajnë dokumentet, sipas pikave 16 e 17, certifikohet nga Kapiteneria e Porteve.

20. Dokumentet e përmendura në pikat 16 e 17 paraqiten për qëllime kontrolli dhe inspektimi, pas kërkesës së autoriteteve përgjegjëse të përcaktuara me ligj.

21. Mjetet lundruese të mbajtura në bordin e anijeve të peshkimit dhe dispozitivat për përqendrimin e peshqve shënjohe me shkronjat dhe numrat e regjistrimit të jashtëm që i përdor anija e peshkimit.

#### KREU IV

##### SISTEMI I KONTROLLIT TË ANIJEVE TË PESHKIMIT

22. Në zbatim të neneve 71 e 72 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, anijet e peshkimit që kanë detyrimin e sistemit të vëzhgimit të anijeve (SVA) nuk mund të largohen nga porti në rast se nuk janë të pajisura me pajisjen përkatëse që mundëson identifikimin dhe lokalizimin e tyre automatik, plotësisht funksional, të instaluar në bord.

23. Kur një anije peshkimi është e ankoruar në port, pajisja që mundëson identifikimin dhe lokalizimin automatik mund të shuhet vetëm në rastet e mëposhtme:

a) kur ka njoftuar paraprakisht QNOD-në;

b) me kusht që komunikimi i ardhshëm të tregojë që anija nuk ka ndryshuar pozicion kundrejt komunikimit të mëparshëm.

Ministria mund të lejojë që njoftimi paraprak sipas shkronjës “a” të zëvendësohet nga një mesazh automatik i SVA-së ose nga një alarm i krijuar nga sistemi, i cili tregon praninë e anijes së peshkimit në një pjesë të caktuar të portit.

24. Pajisjet për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit, garantojnë transmetimin automatik në QNOD, me intervale të rregullta, të të dhënave të mëposhtme:

a) Identifikimin e anijes së peshkimit;

b) Pozicionimin e fundit gjeografik të anijes së peshkimit, me një marzh gabimi më pak se 500 metra dhe besueshmëri prej 99%;

c) Datën dhe orën (të shprehur në “kohën universale” ose UTC), në të cilën është identifikuar pozicioni i anijes;

ç) Shpejtësinë e momentit dhe kursin e anijes.

25. Pajisjet për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit nuk lejojnë regjistrimin dhe transmetimin e pozicioneve të falsifikuara dhe nuk mund ndryshohen në mënyrë manuale.

26. Kapitenët e anijeve të peshkimit marrin masa me qëllim që pajisjet për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit të jenë plotësisht funksionale në çdo moment dhe të transmetojnë të dhënat sipas pikës 24 të këtij vendimi.

27. Me përjashtim të parashikimit në pikën 34, kapitenët e anijeve të peshkimit marrin masa që:

a) të dhënat të mos ndryshohen në asnjë lloj mënyre;

b) antena ose antenat e lidhura me pajisjen për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit të mos bllokohen, zgjidhen ose pengohen në asnjë lloj mënyre;

c) ushqimi me energji i pajisjes për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit të mos ndërpritet asnjëherë;

ç) pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit të mos çmontohet nga anija.

28. Ndalohet prishja, dëmtimi, disaktivizimi ose ndërhyrja në pajisjen për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, me përjashtim të rastit kur riparimi ose zëvendësimi i tyre është i autorizuar nga ministria.

29. Ministria merr masat e duhura për kontrollin dhe vëzhgimin e vazhdueshëm të saktësisë të të dhënave të transmetuara sipas pikës 24 të këtij vendimi, dhe ndërhyrjen menjëherë në rast se verifikohen të dhëna jo të sakta ose jo të plota.

30. QNOD-ja merr nëpërmjet SVA-së, së paku një herë në dy orë, informacionet sipas pikës 24 për anijet shqiptare të peshkimit. QNOD-ja, kur e vlerëson të arsyeshme, mund t'i kërkojë një anijeje peshkimi që sinjali të transmetohet në intervale më të shpeshta.

31. Në zbatim të pikës 2 të nenit 72 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, për përballimin e kostove të transmetimit satelitor apo mesazheve me sistemet e tjera, anijet e peshkimit paguajnë, në numrin e llogarisë të përcaktuar nga ministria, shumën vjetore të transmetimit satelitor apo mesazheve me sistemet e tjera. Pagesa për vitin pasardhës kryhet brenda datës 1 dhjetor të vitit paraardhës. Mirëmbajtja e sistemit të monitorimit, e përcaktuar nga shkronja “b”, e nenit 71 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, përballohet nga buxheti i miratuar i ministrisë.

32. Ministria, për mirëmbajtjen e sistemit të monitorimit dhe për pagesën e kostove *airtime* për anijet e peshkimit, sipas pikës 31, për zgjedh entin i cili plotëson kushtet e vendosura nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe ITU-ja (Konventa e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit), ratifikuar me ligjin nr. 8430, datë 14.12.1998.

33. Pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit jepet falas nga ministria deri më 1 mars 2013. Pas kësaj date, anijet e peshkimit përballojnë kostot e blerjes së pajisjes së mësipërme. Pajisja e blerë dhe e instaluar në bordin e anijes së peshkimit duhet të jetë në përputhje me sistemin e instaluar në QNOD e ministri dhe të plotësojë të gjitha specifikimet sipas pikës 24 të këtij vendimi.

34. Ministria ka për detyrë:

a) të garantojë që të dhënat e mbledhura sipas këtij kreu të regjistrohen në format informatik dhe të ruhen në mënyrë të sigurt në banka të dhënash të informatizuara për, së paku, tre vjet;

b) të marrë të gjitha masat që të garantojë përdorimin e këtyre të dhënave vetëm për qëllime zyrtare;

c) të marrë të gjitha masat teknike për të mbrojtur këto të dhëna nga prishja aksidentale ose e qëllimshme apo çfarëdolloj humbjeje aksidentale, dëmtimi, shpërndarjeje ose konsultimi të paautorizuar.

35. Në zbatim të nenit 74 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, anijet e peshkimit me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 10 metra mbajnë librin e anijes së peshkimit, ku raportojnë për të gjitha veprimet e tyre dhe, në mënyrë specifike, për të gjitha sasitë për secilin lloj të gjuajtur (zënë) e të mbajtur në bord, për një peshë mbi 50 kg peshë e gjallë, ose, kur është e mundur, numrin e individëve përkatës.

36. Ministria mund të vendosë plotësimin e librit të anijes së peshkimit, deklaratës së zbarkimit dhe deklaratës së transbordimit në formatin letër edhe për anijet me gjatësi më të vogël se 10 metra

37. Libri i anijes përfshin, në mënyrë të veçantë, informacionet e mëposhtme:

a) Numrin e identifikimit të jashtëm dhe emrin e anijes së peshkimit;

b) Kodin FAO alfa 3, sipas shtojcës 3, për çdo lloj, dhe zonën gjeografike ku janë kryer zënie;

c) Datën e zënieve;

ç) Datën e nisjes dhe të mbërritjes në port, si dhe kohëzgjatjen e peshkimit;

d) Llojin e mjetit të përdorur, përmasat e rrjetave;

dh) Sasitë e çdo lloji të shprehur në kilogramë të peshës së gjallë, dhe, në rast nevojë, numrin e individëve;

e) Numrin e operacioneve të peshkimit.

Toleranca e lejuar në vlerësimin e sasive në kilogramë, të mbajtura në bordin e anijes dhe të regjistruara në librin e anijes, është 10% për të gjitha llojet.

38. Libri i anijes së peshkimit, në zbatim të pikave 35 e 36 dhe të shtojcës 4 të këtij vendimi, plotësohet nga kapiteni ose një përfaqësues i tij.

39. Kapitenët e anijeve të peshkimit, të cilët regjistrojnë elektronikisht të dhënat që kanë të bëjnë me aktivitetet e tyre të peshkimit, përjashtohen nga detyrimi i plotësimin të librit të anijes së peshkimit në versionin në letër, nga plotësimi i deklaratës së zbarkimit dhe asaj të transbordimit.

40. Libri i anijes, deklarata e transbordimit dhe deklarata e zbarkimit plotësohen sipas formatit të dhënë në shtojcën 5, bashkëlidhur këtij vendimi, edhe në rast se anijet e peshkimit zhvillojnë aktivitet peshkimi në ujërat që rregullohen nga një organizatë rajonale peshkimi. Përjashtim bëjnë rastet kur organizatat rajonale të peshkimit kërkojnë në mënyrë specifike plotësimin dhe paraqitjen e një libri anijeje, deklarate zbarkimi dhe transbordimi të veçantë.

41. Anijet e peshkimit mund të vazhdojnë të plotësojnë formatin e librit të anijes, të përcaktuar nga vendimi nr. 1062, datë 16.7.2008 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kompetencave të Inspektoratit të Peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim”, deri në përfundim të sasive gjendje.

42. Kur një anije peshkimi bën një transbordim në det ose në portin e një shteti tjetër apo zbarkon prodhimin në një port të një shteti tjetër, ia dërgon origjinalet e librit të anijes, deklaratës së transbordimit dhe deklaratës së zbarkimit vëzhguesit të portit të regjistrimit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga trasbordimi ose zbarkimi.

43. Në rast se shteti tjetër ose rregullat e një organizate rajonale peshkimi kërkojnë një lloj tjetër libri anijeje, deklarate trasbordimi ose deklarate zbarkimi, kapiteni i anijes së peshkimit paraqet tek autoritetet përkatëse të shtetit tjetër ose të organizatës rajonale të peshkimit kopje të këtyre dokumenteve sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga trasbordimi ose zbarkimi.

44. Libri i anijes plotësohet me të gjithë informacionin e detyrueshëm edhe në mungesë të zënieve:
- a) çdo ditë, brenda orës 24 ose përpara hyrjes në port;
  - b) gjatë një inspektimi në det;
  - c) në raste të veçanta, të përcaktuara nga ministria.
45. Në librin e anijes plotësohet një rresht i ri:
- a) për çdo ditë në det;
  - b) kur zhvillohet aktivitet në një zonë të ndryshme peshkimi, brenda ditës;
  - c) kur hidhen të dhënat në lidhje me sforcën e peshkimit.
46. Në librin e anijes plotësohet një faqe e re:
- a) kur përdoret një rrjetë me syze, me dimensione të ndryshme nga ato të rrjetës së përdorur më parë;
  - b) për çdo operacion peshkimi të bërë pas një transbordimi ose zbarkimi të ndërmjetëm;
  - c) kur numri i kolonave nuk është i mjaftueshëm;
  - ç) në momentin e nisjes nga një port, kur nuk është bërë zbarkim.
47. Sasitë për secilin lloj tregohen në një faqe të re të librit të anijes, në momentin e nisjes nga një port ose në përfundim të një operacioni transbordimi, si dhe kur një pjesë e zënieve qëndrojnë në bord.
48. Kodet e veglave të peshkimit ndodhen në shtojcën 6 të këtij vendimi.
49. Gjatë një operacioni transbordimi midis dy anijeve shqiptare, me përfundimin e operacionit, kapiteni i anijes që jep prodhimet ose përfaqësuesi i tij i dorëzon një kopje të deklaratës së transbordimit të anijes së tij kapitenit që merr prodhimin ose përfaqësuesit të tij. Në përfundim të operacionit të transbordimit, kapiteni i anijes në të cilën shkojnë prodhimet ose përfaqësuesi i tij i dorëzon një kopje të deklaratës së transbordimit kapitenit të anijes që jep prodhimin ose përfaqësuesit të tij.
50. Kapiteni ose përfaqësuesi i tij nënshkruajnë reciprokisht çdo faqe të deklaratës së zbarkimit.
51. Ministria përcakton me rregullore të veçantë koeficientët e konvertimit të peshës së peshkut në bord, të magazinuar dhe përpunuar në peshë të gjallë.
52. Në zbatim të nenit 79 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, ministria harton një program kombëtar kampionimi, duke përcaktuar metodikën e përdorur për hartimin e tij. Programi i kampionimit është i qëndrueshëm në kohë dhe i përcaktuar sipas zonave gjeografike. Programi i kampionimit ka për qëllim regjistrimin e të dhënave nga zëniet dhe të sforcos së peshkimit.
53. Programi i kampionimit hartohet sipas shtojcës 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
54. Madhësia e kampionit objekt inspektimi përcaktohet mbi bazën e riskut, sipas modaliteteve të mëposhtme:
- a) risk “shumë i ulët”: 3% e kampionit;
  - b) risk “ i ulët”: 5% e kampionit;
  - c) risk “mesatar”: 10% e kampionit;
  - ç) risk “i lartë”: 15% e kampionit;
  - d) risk “shumë i lartë”: 20% e kampionit.
55. Zëniet ditore të një segmenti të flotës për një popullatë të caktuar llogariten duke shumëzuar numrin total të anijeve aktive të këtij segmenti të flotës me zëniet ditore mesatare për secilën popullatë të përcaktuar nga çdo anije e flotës, mbi bazën e zënieve të kampionimit të anijeve nën monitorim.
56. Në rastin kur ministria vendos detyrimin e plotësimit të librit të anijes nga anijet e peshkimit më të vogla se 10 metra, programi i inspektimit nuk i përfshin këto anije. Faturat e shitjes së prodhimit pranohen si alternativë e programit të kampionimit.
57. Në rastin kur kapiteni i një anijeje peshkimi transmeton të dhënat sipas nenit 115 të ligjit, ministria përcakton stacionet radio që do të përdoren dhe e publikon atë në faqen zyrtare.
58. Në zbatim të nenit 102 të ligjit, një motor anijeje quhet i modifikuar teknikisht në rastet kur një nga komponentët e tij kryesorë dhe pjesët e këmbimit të përfshira, si: injektorët, valvolat, turbinat e motorit, pistonat, këmishat e cilindrave dhe testatot modifikohen ose zëvendësohen me pjesë të tjera me karakteristika teknike të ndryshme, që çojnë në një modifikim të fuqisë motorike të deklaruar, ose kur modifikohet tarimi i motorit, si injektimi, konfigurimi i turbove ose faza e valvolave.
59. Pronari i anijes së peshkimit njofton përpara vendosjes së motorit të ri ose modifikimit teknik të motorit ekzistues.
60. Neni 102 i ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, zbatohet për anijet e peshkimit që janë subjekt i një sforcoje peshkimi të përcaktuar, duke filluar nga 1 janari i vitit 2014. Për të gjitha anijet e tjera zbatimi i detyrimit fillon nga 1 janari i vitit 2015. Kjo pikë zbatohet për anijet e peshkimit në të cilat janë

montuar motorë të rinj ose ku motorët ekzistues janë zëvendësuar apo ndryshuar teknikisht, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

61. Pas një analize të rrezikut dhe sipas një plani kampionimi, të bazuar në metodologjinë e parashikuar sipas pikës 53 të këtij vendimi, ministria kryen verifikime të përputhshmërisë të të dhënave në lidhje me fuqinë motorike, duke përdorur të gjitha informacionet që administrata disponon, veçanërisht, për karakteristikat teknike të anijes në fjalë. Në mënyrë të veçantë verifikohen informacionet që lidhen me:

- a) të dhënat e mbledhura nga sistemi i kontrollit të anijeve të peshkimit;
- b) librat e anijeve;
- c) certifikatat e klasifikimit, të lëshuara nga shoqëria klasifikuese;
- ç) certifikatën e kolaudimit në det, të lëshuar nga shoqëria klasifikuese;
- d) regjistrin e flotës së peshkimit;

dh) çfarëdolloj dokumenti që jep informacione në lidhje me fuqinë motorike apo karakteristika teknike të tjera të lidhura më të.

62. Në rast se, pas analizës së informacioneve të përmendura në pikën 68 të këtij vendimi, ka të dhëna se fuqia e motorit të një anijeje peshkimi është më e lartë se ajo e shënuar në lejen e peshkimit, ministria, nëpërmjet Inspektoratit të Peshkimit, kryen një kontroll fizik të kësaj fuqie.

63. Me qëllim verifikimit të fuqisë motorike sipas pikës 61 të këtij vendimi, ministria harton një plan kampionimi për të identifikuar anijet ose grup-anijet për të cilat ekziston rreziku i deklarimit të një fuqie motorike më të vogël se ajo ekzistuese. Plani i kampionimit bazohet në këto kritere të rrezikut të lartë:

a) Anije që kryejnë aktivitet në zona peshkimi dhe që bëjnë pjesë në një regjim të sforcos së peshkimit të përcaktuar, në mënyrë të veçantë për ato anije për të cilat është caktuar një sforcë individuale e shprehur në kW\*ditë;

b) Anije që janë subjekt i kufizimeve të fuqisë motorike;

c) Anije që kanë një raport midis fuqisë motorike (KS) dhe tonazhit të anijes (GT) më të vogël se 50% kundrejt raportit mesatar për të njëjtin lloj anijeje dhe për të njëjtat mjete peshkimi dhe lloje objekt peshkimi. Për kryerjen e kësaj analize, ministria mund të klasifikojë flotën e peshkimit sipas disa kritereve, ndër të cilat:

- i) segmentimi ose njësitë operacionale;
- ii) kategoritë në lidhje me gjatësinë;
- iii) kategoritë në lidhje me tonazhin;
- iv) mjetet e peshkimit të përdorura;
- v) llojet objekt peshkimi.

64. Inspektorati i Peshkimit përzgjedh një kampion rastësor të anijeve të peshkimit nga një grup anijesh që i përket njërit prej kritereve të rrezikut sipas pikës 54 të këtij vendimi. Madhësia e kampionit është e barabartë me rrënjën katrore, të rrumbullakosur me shifrën e plotë më të afërt të numrit të anijeve të peshkimit që përbëjnë grupin e anijeve.

65. Inspektorati i Peshkimit verifikon dokumentet teknike sipas pikës 58 të këtij vendimi, të mbajtura nga anija e peshkimit e përfshirë në kampionimin rastësor. Në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 61 të këtij vendimi, Inspektorati i Peshkimit kontrollon specifikimet teknike sipas katalogut të motorit.

66. Pikat 62 e 63 të këtij vendimi, që lidhen me kontrollet fizike, zbatohen kryesisht për anijet me trata tërheqëse që janë subjekt i kufizimeve të sforcos së peshkimit nga 1 janari i vitit 2013.

## KREU V

### KONTROLI I PESHKIMIT ÇLODHËS ARGËTUES

67. Ndalohet peshkimi çodhës argëtues për popullatat që janë objekt të planeve të rehabilitimit.

68. Në zbatim të pikës 4 të nenit 47 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, KKSHTE-ja jep mendim për përcaktimin termave teknikë për monitorimin dhe përmirësimin e planeve të kampionimit për peshkimin çlodhës argëtues.

## KREU VI

### KONTROLI TREGTIMIT

69. Në zbatim të nenit 111 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, për prodhimet e peshkimit dhe akuakulturës, etiketa përmban, përveç kërkesave të parashikuara nga neni 36 i ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, edhe informacionet shtesë, si më poshtë vijon:

a) Numrin e identifikimit të jashtëm të anijes së peshkimit apo emrin e njësisë së prodhimit në akuakulturë;

b) Kodin FAO alfa 3 të çdo lloji;

c) Datën e zënieve apo datën e prodhimit;

ç) Sasi të e çdo lloji në kg të peshës neto apo, nëse është e mundur, numrin e individëve;

d) Nëse produktet e peshkimit janë ngrirë paraprakisht.

70. Në rastin kur një prodhim i peshkimit ose akuakulturës ka qenë i ngrirë paraprakisht, shprehja “i shkrirë” shkruhet në etiketë ose në markë. Mungesa e kësaj shprehjeje në shitjen me pakicë tregon se prodhimet e peshkimit dhe të akuakulturës nuk kanë qenë të ngrira paraprakisht, pra, nuk janë të shkrira.

71. Etiketa e mënyrës së prodhimit përmban shënimin e mëposhtëm, në rast se kemi të bëjmë me prodhime deti, prodhime të ujërave të brendshme ose të akuakulturës:

a) Peshkuar;

b) Peshkuar në ujërat e brendshme;

c) Rritje.

72. Informacioni i parashikuar në pikën 69 të këtij vendimi, si dhe emri tregtar, emri shkencor, zona e peshkimit dhe mënyra e prodhimit vihen në dispozicion të konsumatorit në momentin e shitjes me pakicë.

73. Në zbatim të nenit 109 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, inspektorët për peshkimin kontrollojnë hedhjen në treg të prodhimeve peshkore dhe të akuakulturës, vetëm në lidhje me respektimin e llojeve të peshqve, kohët dhe zonat e ndalimit të tyre, dimensionet e lejuara, si dhe të origjinës.

74. Lidhur me origjinën, inspektorët e peshkimit kontrollojnë nëse prodhimet e peshkimit vijnë nga anije/mjete lundruese të pajisura me leje të vlefshme peshkimi ose njësi prodhimi të akuakulturës të lejuara.

75. Në zbatim të nenit 110 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, inspektorët për peshkimin bashkëpunojnë me Rojën Bregdetare, Kapitenerinë e Porteve, Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, organet tatimore apo edhe organe të tjera, të cilat, sipas ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, ose sipas ligjeve specifike respektive në fuqi, kontrollojnë hallka të caktuara të peshkimit.

76. Në rastet kur, si rezultat i bashkimit ose ndarjes në sasi më të vogla, pas shitjes së parë, prodhimet e peshkimit dhe akuakulturës që vijnë nga anije peshkimi të ndryshme ose njësi prodhimi akuakulture të ndryshme përzihen, subjektet duhet të jenë në gjendje të identifikojnë, në rast se u kërkohet, çdo sasi, bazuar në pikën 69 të këtij vendimi, me qëllim identifikimin e stadi të zënies ose njësisë së prodhimit.

77. Zonat e zënieve përkufizohen si më poshtë:

Zona e zënies	Përkufizimi i zonës
Atlantiku veriperëndimor	Zona FAO n. 21
Atlantiku verilindor	Zona FAO n. 27
Deti Baltik	Zona FAO n. 27.III d
Atlantiku qendror-perëndimor	Zona FAO n. 31
Atlantiku qendror - lindor	Zona FAO n. 34
Atlantiku jugperëndimor	Zona FAO n. 41
Atlantiku juglindor	Zona FAO n. 47
Deti Mesdhe	Zonat FAO n. 37.1 dhe 37.3
Deti Mesdhe (deti Jon dhe Adriatik)	Zona FAO n. 37.2
Deti i Zi	Zona FAO n. 37.4
Oqeani Indian	Zonat FAO n. 51 e 57
Oqeani Paqësor	Zonat FAO n. 61, 67, 71, 77, 81 dhe 87
Antarktiku	Zonat FAO n. 48, 58 e 88
Vjetari FAO. Statistikat e peshkimit. Zëniet, Vol.86/1.2000	

78. Detyrimi i tregtimit dhe regjistrimit të të gjitha prodhimeve të peshkimit në qendrat përkatëse të ankandit lind në momentin kur ndërtohen qendrat e ankandit me shumicë në portet dhe qendrat e peshkimit.

## PESHIMI I PRODHIMEVE TË PESHKIMIT

79. Ky kre zbatohet për të gjitha zbarkimet e kryera nga anijet shqiptare të peshkimit, transbordimet midis anijeve të kryera në porte ose vende pranë brigjeve, sikurse peshimet e prodhimeve të peshkimit në bordin e anijeve të peshkimit, në ujërat e Republikës së Shqipërisë.

80. Blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat apo personat përgjegjës për hedhjen në treg për herë të parë, ose të magazinimit përpara hedhjes në treg për herë të parë të prodhimeve peshkore, apo, nëse është e nevojshme, kapitenët e anijeve të peshkimit regjistrojnë peshimin e kryer sipas neneve 112 e 113 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, duke treguar informacionet e mëposhtme:

- a) Kodin FAO alfa-3 të llojit të peshuar;
- b) Rezultatin e peshimit për secilën sasi të secilit lloj, në kilogram prodhim;
- c) Numrin e identifikimit të jashtëm dhe emrin e anijes së peshkimit nga vjen sasia e peshuar; ç) Paraqitjen e prodhimeve të peshkimit, të peshuara;
- d) Datën e peshimit (VVVV-MM-DD).

81. Blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat apo personat përgjegjës për hedhjen në treg për herë të parë ose të magazinimit përpara hedhjes në treg për herë të parë të prodhimeve peshkore ose, nëse është e nevojshme, kapitenët e anijeve të peshkimit, i ruajnë regjistrat sipas pikës 80 të këtij vendimi, për një periudhë trevjeçare.

82. Përpara peshimit, blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat apo personat përgjegjës për hedhjen në treg për herë të parë të prodhimeve peshkore heqin akullin nga prodhimet peshkore në një masë të konsiderueshme, pa shkaktuar prishje të prodhimit ose ulje të cilësisë.

83. Me përjashtim për llojet pellagjike, të cilat zbarkohen pa arka për t’u transferuar në vendin e hedhjes së parë në treg, të magazinimit ose përpunimit, uji dhe akulli që i hiqet peshës totale nuk i kalon 2%. Në të gjitha rastet përqindja e ujit ose akullit të zbritur shënohet në dokumentin e peshimit, së bashku me regjistrimin e peshës.

84. Në zbatim të neneve 115 e 116 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, dokumenti i shitjes, i hartuar sipas formatit të dhënë në shtojcën 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përmban informacionet e mëposhtme:

- a) Numrin e jashtëm të identifikimit të anijes që ka zbarkuar prodhimin;
- b) Portin dhe datën e zbarkimit;
- c) Emrin e përdoruesit ose kapitenit apo, në rast se është një person i ndryshëm, emrin e shitësit; ç) Emrin e blerësit, numrin e NIPT-it;
- d) Kodin FAO alfa 3, të secilit lloj dhe të zonës gjeografike në të cilën është kryer peshkimi. dh)Sasitë për secilin lloj, të shprehura në kilogramë prodhim, të ndara për mënyrën e paraqitjes ose, nëse është rasti, numrin e individëve;
- e) Të dhënat e nevojshme për të gjitha ato lloje për të cilat ka kufizime në lidhje me tregtinë, peshën gjendje, paraqitjen dhe freskinë;
- ë) Destinacionin, nëse është e nevojshme, për prodhimet e hequra nga tregu (gruposje, ushqim për kafshë, prodhim miell peshku për ushqime për kafshë ose për qëllime joushqimore);
- f) Vendin dhe datën e shitjes;
- g) Nëse është e mundur, numrin e referimit, datën e faturës dhe, eventualisht, të kontratës së shitjes;
- gj)Nëse është rasti, deklaratën e marrjes në ngarkim, sipas pikës 96 të këtij vendimi, ose dokumentin e transportit; h) çmimin.

85. Në rastet e parashikuara nga neni 81 i ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, Drejtoria e Peshkimit dërgon pranë autoriteteve kompetente të shtetit, flamurin e të cilit anija mban, dhe një kopje të dokumentit të shitjes, mundësisht në format elektronik.

86. Blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat, apo personat përgjegjës, me një xhiro vjetore të barabartë ose më të vogël se 30 milionë lekë, brenda 24 orëve nga përfundimi i shitjes së parë, dërgojnë një kopje të dokumentit të shitjes, mundësisht në format elektronik, pranë monitorëve të peshkimit.

87. Ministria mund të përjashtojë nga detyrimi i plotësimit të deklaratës së shitjes anijet e peshkimit/mjetet lundruese me gjatësi më të vogël se 10 metra, vetëm në rast se është në zbatim një plan kampionimi i vlefshëm.

88. Në rast se prodhimet e peshkimit janë të destinuar për një shitje të mëtejshme, blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat apo personat përgjegjës për shitjen e parë të prodhimeve të peshkimit, me një xhiro vjetore të barabartë ose më të vogël se 30 milionë lekë, transmetojnë, brenda 48 orëve



nga kryerja e zbarkimit, një deklaratë të marrjes në dorëzim të monitorët e peshkimit të zonës ku është kryer marrja në dorëzim. Blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat, apo personat përgjegjës për shitjen e parë të prodhimeve të peshkimit janë përgjegjës për transmetimin e deklaratës së shitjes dhe saktësinë e saj.

89. Deklarata e marrjes në dorëzim, sipas shtojcës 9, përmban, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) Numrin e identifikimit të jashtëm të anijes së peshkimit që ka zbarkuar prodhimin;
- b) Portin e zbarkimit;
- c) Emrin e përdoruesit ose kapitenit të anijes;
- ç) Kodin FAO alfa 3, të çdo lloji, dhe zonën gjeografike në të cilën janë kryer zëniet;
- d) Sasitë për çdo lloj të magazinuar, të shprehur në kilogram peshë të prodhimit, të ndarë për mënyrën e paraqitjes, ose, nëse është e nevojshme, në numër individësh;
- dh) Emrin dhe adresën e mjediseve të magazinimit;
- e) Nëse është e nevojshme, referimin e numrit të dokumentit të transportit, sipas pikës 100 të këtij vendimi.

90. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në planet shumëvjeçare dhe në rast se prodhimet e peshkimit janë të destinuara për shitje të mëtejshme, blerësit e regjistruar, qendrat e ankandit ose organizmat apo personat përgjegjës, me një xhiro vjetore të barabartë ose më të vogël se 30 milionë lekë, regjistrojnë informacionet sipas pikës 80 të këtij vendimi, dhe i dërgojnë në mënyrë elektronike të monitorët e peshkimit të portit ku është kryer zbarkimi.

91. Prodhimet e peshkimit të zbarkuara në portet shqiptare, të papërpunuara ose të përpunuara në bordin e anijes, për të cilat nuk është paraqitur një deklaratë shitjeje dhe marrjeje në dorëzim, sipas pikave 83 dhe 89 të këtij vendimi, dhe që transportohen në një vend të ndryshëm nga vendi i zbarkimit, shoqërohen nga një dokument i plotësuar nga mjeti i transportit deri në vendin ku kryhet shitja e parë. Brenda 48 orëve nga ngarkimi i mjetit të transportit, ky dokument u dërgohet monitorëve lokalë në territorin e të cilëve është kryer zbarkimi.

92. Mjeti i transportit përjashtohet nga detyrimi i pajisjes me dokumentin e transportit që shoqëron prodhimet peshkore, në rast se ky dokument është dërguar në mënyrë elektronike, përpara fillimit të transportit të monitorët lokalë ose në rast se transportohen brenda portit apo në një distancë më të vogël se 20 kilometra.

93. Drejtuesi i mjetit të transportit është përgjegjës për saktësinë e dokumentit të transportit. Dokumenti i transportit plotësohet sipas shtojcës 10 të këtij vendimi, dhe specifikon:

- a) destinacionin e sasisë dhe identifikimin e mjetit të transportit;
- b) numrin e identifikimit të jashtëm të anijes që ka zbarkuar prodhimet;
- c) kodin FAO alfa 3, të çdo lloji, dhe zonën gjeografike në të cilën janë kryer zëniet;
- ç) sasitë e transportuara për çdo lloj, të shprehura në kilogram, të prodhimit, të ndarë, nëse është e nevojshme, për mënyrën e paraqitjes, ose nëse është në numër individësh;
- d) vendin dhe datën e ngarkimit.

94. Mjeti i transportit përjashtohet nga detyrimi i pajisjes me dokumentin e transportit që shoqëron prodhimet peshkore, në rast se ky dokument zëvendësohet nga një kopje e deklaratës së zbarkimit që tregon sasitë e transportuara, ose një dokument i ngjashëm me to.

## KREU VIII

### MBIKËQYRJA DHE INSPEKTIMI

#### SEKSIONI I

#### MBIKËQYRJA

95. Në rastet kur nga mbikëqyrja e parashikuar nga neni 71 i ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të dhënat nuk korrespondojnë, QNOD-ja njofton Inspektoratin e Peshkimit për të hetuar më tej dhe për të vendosur për masat që duhet të merren.

96. Në rastet kur mbikëqyrja ose kontrolli në det ka të bëjë me një anije të huaj, pa përjashtuar zbatimin e masave të parashikuara nga ligji nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, QNOD-ja harton një raport mbikëqyrjeje, duke përshkruar të gjitha gjetjet që kanë rezultuar. Ky raport i transmetohet pa

asnjë vonesë, në rrugë elektronike, Drejtorisë së Peshkimit, e cila ia dërgon shtetit flamurin e të cilit anija mban. Në rastin e një anijeje që mban flamurin e një shteti të Bashkimit Europian, Drejtoria e Peshkimit ia dërgon një kopje të këtij raporti edhe drejtorisë përkatëse të Komisionit Europian.

97. Në rastet kur përfaqësuesi i ministrisë në QNOD ka vëzhguar ose lokalizuar një anije peshkimi që është duke kryer një aktivitet i cili mund të konsiderohet në shkelje të rregullave të politikës shqiptare të peshkimit, ai plotëson pa vonesë një raport mbikëqyrjeje dhe ia dërgon Drejtorisë së Peshkimit. Përmbajtja dhe formati i raportit të mbikëqyrjes përcaktohen me urdhër të ministrit.

98. Drejtoria e Peshkimit hedh të dhënat që përmban raporti i mbikëqyrjes në një bankë të dhënash elektronike. Në këtë bankë të dhënash mund të hidhet edhe një kopje e skanerizuar e raporteve të mbikëqyrjes. Të dhënat e raporteve hidhen në faqen elektronike, në pjesën e mbrojtur të saj, dhe ruhen për një periudhë trevjeçare.

99. Në momentin e marrjes së një raporti mbikëqyrjeje, Drejtoria e Peshkimit fillon sa më shpejt të jetë e mundur një hetim mbi aktivitetin e anijeve të peshkimit të përfshira në raport.

## SEKSIONI II

### VËZHguesIT E KONTROLLIT

100. Me përjashtim të rregullave të vendosura nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, anijet e peshkimit, të përzgjedhura për zbatimin e një programi vëzhgimi, mbajnë në bord, të paktën, një vëzhgues për periudhën e përcaktuar në program.

101. Për të qenë të pavarur nga pronari, nga përdoruesi, nga kapiteni dhe nga cilido anëtar i ekuipazhit të një anijeje peshkimi, vëzhguesit nuk duhet të jenë:

a) të afërm ose vartës të kapitenit të anijes së peshkimit, apo të cilitdo anëtar të ekuipazhit, të përfaqësuesve të kapitenit, përdoruesit ose pronarit të anijes në të cilën janë caktuar;

b) të punësuar në ndonjë aktivitet që kontrollohet nga kapiteni, nga ndonjë anëtar i ekuipazhit, përfaqësues të kapitenit, përdoruesi ose pronari i anijes në të cilën janë caktuar.

102. Vëzhguesit hartojnë një raport sipas formatit të dhënë në shtojcën 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilin e dërgojnë pa vonesë, por në çdo rast jo më vonë se 30 ditë, në drejtori.

## SEKSIONI III

### INSPEKTORËT

103. Në zbatim të pikës 1 të nenit 121 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, ministria pajis inspektorët për peshkimin me një dokument identifikimi të shërbimit, i cili specifikon identitetin dhe gradën. Inspektori në shërbim e mban me vete dokumentin e identifikimit dhe e paraqet atë në rastin më të parë gjatë një inspektimi.

104. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në planet shumëvjeçare, Inspektorati i Peshkimit harton një qasje të bazuar mbi riskun për përzgjedhjen e anijeve që do të inspektohen, duke konsultuar të gjithë informacionin e disponueshëm.

105. Në përputhje me programin e kontrollit, Inspektorati i Peshkimit kryen inspektimin në mënyrë objektive me qëllim parandalimin e mbajtjes në bord, transbordimin, zbarkimin, transferimin në arka ose në impiante të akuakulturës, transportin, magazinimin dhe tregtimin e prodhimeve peshkore me prejardhje nga aktivitete që nuk janë në përputhje me legjislationin në fuqi. Inspektimet kryhen në mënyrë të tillë që të parandalojnë sa më shumë të jetë e mundur ndikimet negative mbi higjienën dhe cilësinë e prodhimeve të peshkimit, që inspektohen.

106. Inspektorët, në fazën përgatitore të një inspektimi, grumbullojnë të gjithë informacionin e mundshëm dhe, në mënyrë të veçantë:

a) Lejet dhe autorizimet në peshkim;

b) Informacione nga SVA-ja në lidhje me aktivitetin në proces të peshkimit;

c) Vëzhgime nga sisteme të tjera;

ç) Raporte të inspektimeve të mëparshme dhe informacione që ndodhen në faqen elektronike, të mbrojtur, të ministrisë.

107. Çdo mjet lundrues i përdorur për kontrollin dhe vëzhgimin e peshkimit mban një flamur ose shenjë të dukshme, sipas shtojcës 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Shenja ose flamuri është me përmasa me madhësi në përputhje me madhësinë e mjetit lundrues, për të treguar që është duke kryer një inspektim në peshkim. Drejtuesit e mjetit të lundrimit zbatojnë me rigorozitet rregullat e lundrimit dhe manovrës, në një distancë sigurie nga anija e peshkimit, në përputhje me rregullat e parandalimit të përplasjeve në det.

108. Inspektorët nuk i kërkojnë anijes, në të cilën kanë synim të ngjiten ose nga e cila duan të zbresin, të ndalojë ose të manovrojë në momentet kur ajo është duke kryer aktivitetet peshkimi, duke hedhur ose duke ngritur rrjetën. Inspektorët kanë të drejtë të kërkojnë ndalimin ose shtyrjen, hedhjen e veglave të peshkimit për të mundësuar imbarkimin ose zbarkimin në siguri të plotë, deri në momentin kur ata kanë hipur ose zbritur nga anija. Në rast imbarkimi, kjo vonesë nuk mund të kalojë 30 minuta nga imbarkimi i inspektorëve, me përjashtim të rasteve kur është konstatuar një shkelje. Ky rregull nuk parandalon inspektorët të kërkojnë që veglat e peshkimit të ngrihen me qëllim inspektimin e tyre.

109. Inspektorët verifikojnë dhe mbajnë shënim të gjithë zërat e formatit të shtojcës 13 të këtij vendimi, gjatë kryerjes së inspektimit në det, në port, në transport apo në tregje. Inspektorët mund t'i kërkojnë kapitenit të ngrejë një vegël peshkimi me qëllim inspektimin e saj.

110. Kohëzgjatja e inspektimit nuk i kalon katër orët dhe nuk zgjatet përtej kohës së nevojshme të imbarkimit në anije, të inspektimit të rrjetave e të zënieve edhe në rastet kur për këto aktivitete nevojitet më shumë kohë. Kjo nuk zbatohet në rast se konstatohet një shkelje flagrante ose në rast se inspektorët kanë nevojë për më shumë kohë për informacione shtesë.

111. Në rast se inspektorët e peshkimit konstatojnë gabime në regjistrin për zëniet, që janë objekt i planeve shumëvjeçare, për sasi më të mëdha se 500 kg ose prej 10%, të llogaritur në përqindje të të dhënave të librit të anijes, ose për të gjitha rastet e parashikuara nga neni 117 i ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", mund t'i kërkojnë anijes së peshkimit të kthehet menjëherë në port, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë.

112. Në rastet kur konstatohet një shkelje flagrante, mund të plumbosen ose të vendosen vula në çdo pjesë të veglave të peshkimit ose anijes, përfshirë mbajtësit e prodhimit ose mjediseve ku këto të fundit mbahen. Inspektorët mund të qëndrojnë në bord për gjithë kohën e duhur për të marrë masat e nevojshme me qëllim garantimin e sigurisë dhe për mosdëmtimin e provave të shkeljes flagrante.

113. Inspektimi në port kryhet në këto raste:

- a) Zakonisht, në bazë të një metodologjie të bazuar mbi kampionimin dhe në menaxhimin e riskut;
- b) Kur ka dyshime për shkeljen e legjislacionit përkatës në fuqi.

114. Në rastet e përmendura në shkronjën "b" të pikës 113, përfaqësuesit e Inspektoratit të Peshkimit janë të pranishëm në port në momentin e mbërritjes së anijes së peshkimit. Pika 113 nuk përjashton mundësinë e inspektimeve rastësore.

115. Ndërsa kryejnë inspektimin e zbarkimit, inspektorët kontrollojnë të gjithë procesin e zbarkimit që nga fillimi deri në fund të tij. Gjatë inspektimit kryhen verifikime të kryqëzuara ndërmjet sasive për lloj, të deklaruara sipas nenit 82 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 "Për peshkimin", sasive për lloj të regjistruara në librin e anijes dhe sasive për lloj të zbarkuara ose të transborduar. Kjo pikë nuk përjashton mundësinë që inspektimi të kryhet edhe kur zbarkimi të ketë filluar.

116. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në planet shumëvjeçare, Inspektorati i Peshkimit kryen inspektime të transportit kudo dhe në çdo moment, që nga pika e zbarkimit, me mbërritjen e prodhimeve të peshkimit, deri drejt vendeve të shitjes dhe përpunimit. Gjatë inspektimeve merren masat e nevojshme që të garantohet zinxhiri i ftohjes së prodhimeve peshkore të inspektuara. Këto inspektime përfshijnë, atje ku është e mundur, edhe inspektime fizike.

117. Në rastet kur një automjet ose kontejner plumboset për të evituar prekjen e mallit, Inspektorati i Peshkimit regjistron në dokumentacion numrin e serisë së plumbçeve. Inspektorët verifikojnë nëse plumbçet janë të paprekura dhe që numrat e serisë të korrespondojnë me ato që janë shkruar në dokumentin e transportit. Në rast se plumbçet hiqen për të kryer një inspektim, inspektorët e peshkimit i zëvendësojnë plumbçet, duke shkruar në dokumentin e transportit numrat e rinj dhe arsyet e heqjes së atyre origjinale.

## KREU X

### DETYRIMET E OPERATORËVE

118. Të gjithë operatorët, që janë subjekt i një inspektimi, duhet:

a) të lehtësojnë punën e inspektorëve dhe t'u japin atyre të gjitha informacionet që kërkojnë, si dhe dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, kopje të tyre, ose të mundësojnë hyrjen në bankat e të dhënave të rëndësishme në lidhje me aktivitetin e peshkimit, që duhet të plotësohen ose të ruhen në format elektronik ose shkresor, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të lehtësojnë punën e inspektorëve në çdo pjesë të anijes, mjediseve dhe në çdo mjet transporti që ka lidhje me aktivitetin e peshkimit ose përpunimin;

c) të garantojnë në çdo moment sigurinë e inspektorëve, t'i asistojnë në mënyrë aktive dhe të bashkëpunojnë me ta për kryerjen e detyrave të inspektimit;

ç) të mos pengojnë, kërcënojnë, ndërhyjnë dhe parandalojnë që persona të tjerë të pengojnë, të kërcënojnë ose ndërhyjnë, ndërsa inspektorët kryejnë funksionet e tyre;

d) të vënë në dispozicion, atje ku është e mundur, një mjedis për mbledhje, të izoluar, në të cilin vëzhguesit japin informacion për inspektorët.

119. Kapitani ose përfaqësuesi i një anijeje peshkimi, që i nënshtrohet një inspektimi, ka për detyrë:

a) të lehtësojë imbarkimin e shpejtë dhe të sigurt të inspektorëve, në përputhje me rregullat e lundrimit, në momentin që merr sinjalin ose kur qëllimi për të hipur në bord është konfirmuar nëpërmjet radio-komunikimit;

b) të vërë në dispozicion të inspektorëve infrastrukturën për t'u ngjitur në bord;

c) t'i lejojë inspektorët të kryejnë funksionet e inspektimit, duke ofruar asistencë të arsyeshme;

ç) t'i lejojë inspektorët të komunikojnë me autoritetet e tjera;

d) t'i informojë inspektorët për rreziqet specifike për sigurinë në bordin e anijes së peshkimit;

dh) të lejojë hyrjen e inspektorëve të peshkimit në të gjitha zonat e anijes së peshkimit, të zënieve të përpunuara ose jo, të të gjitha veglave të peshkimit dhe në të gjitha dokumentet e informacionet;

e) të mundësojë zbarkimin e sigurt të inspektorëve në fund të inspektimit.

120. Vendimi nr. 1062, datë 16.7.2008 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kompetencave të Inspektoratit të Peshkimit dhe ngritjen e sistemit të kontrollit, për zbatimin e politikave menaxhuese në peshkim", shfuqizohet.

121. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## SHTOJCA 1

### INFORMACIONI MINIMAL I LEJEVE TË PESHKIMIT (AKTI I MIRATIMIT)

#### 1. TË DHËNAT NË LIDHJE ME ANIJEN E PESHKIMIT

Numri i Regjistrit të Anijeve të Peshkimit (RAP)

Emri i anijes së peshkimit

Flamuri

Porti i ushtrimit të veprimtarisë

Numri i jashtëm i identifikimit

Sinjali radio i thirrjes [IRCS (nëse ka)]

#### 2. TITULLARI I LEJES/PRONARI I ANIJES SË PESHKIMIT /AGJENTII ANIJES SË PESHKIMIT

Emri dhe adresa e personit fizik ose juridik

#### 3. KARAKTERISTIKAT E KAPACITETIT TË PESHKIMIT

Fuqia motorike (KS)

Pesha (GT)

Gjatësia totale

Mjetet e peshkimit kryesor

Mjetet e peshkimit dytësore (nëse ka)

Masat kufizuese të zbatueshme

## SHTOJCA 2

INFORMACIONI MINIMAL PËR AUTORIZIMET NË PESHKIM

IDENTIFIKIMI

1. Numri i Regjistrit të Anijeve të Peshkimit (RAP)
2. Emri i anijes së peshkimit
3. Numri i jashtëm i identifikimit

KUSHTET E PESHKIMIT

1. Data e lëshimit
2. Vlefshmëria
3. Kushtet e autorizimit, përfshirë nëse është e nevojshme, llojet zonat dhe mjetet e peshkimit.

	Nga __/__/__ Deri __/__/__	Nga __/__/__ Deri __/__/__	Nga __/__/__ Deri __/__/__	Nga __/__/__ Deri __/__/__	Nga __/__/__ Deri __/__/__
<b>Zona</b>					
<b>Llojet</b>					
<b>Mjeti i peshkimit</b>					
<b>Kushte të tjera</b>					

Eventualisht kushte të tjera që rrjedhin nga autorizimi i peshkimit.

SHTOJCA 3

LISTA E LLOJEVE DHE KODI FAO ALFA 3

3A CODE	Llojet	Emri Fish Base	Emri shqip
WAH	Acanthocybium solandri	Wahoo	
APB	Acipenser baerii baerii	Siberian sturgeon	
APG	Acipenser gueldenstaedtii	Danube sturgeon	
AAA	Acipenser naccarii	Adriatic sturgeon	Blini i bardhë
APE	Acipenser stellatus	Starry sturgeon	Bli turigjatë
APU	Acipenser sturio	Sturgeon	Blini turigjatë
STU	Acipenseridae		Blinjtë
ABI	Alburnoides bipunctatus	Schneider	Barkgjera
ABD	Alburnus albidus	Italian bleak	
ALR	Alburnus alburnus	bleak	Cironka
ALV	Alopias vulpinus	Thresher	Peshkdhelper
BBH	Alosa aestivalis	Agone	Kubla
TSD	Alosa fallax	Twaite shad	Kubla
ITM	Ameiurus melas	Black bullhead	Peshku mace e zezë
ITE	Ameiurus nebulosus	Brown bullhead	Peshku mace kafe
ELE	Anguilla anguilla	European eel	Ngjala
ELX	Anguilla spp	Eels	Ngjalat
AHN	Anthias anthias	Swallowtail seaperch	Shkerp kuqalosh
AFD	Aphanius dispar		Çeliku
AFS	Aphanius fasciatus		Çeliku
AFJ	Aphanius iberus	Spanish toothcarp	Larëza vizake
FIM	Aphia minuta	Transparent goby	
OGT	Apogon imberbis	Cardinal fish	Mbreti i gjelave
AOK	Aptерichthys kendalli	European finless eel	
ARY	Argentina sphyraena	Argentine	Troftë deti
SEE	Argyropelecus aculeatus	Half-naked hatchetfish	Sopateza
MGR	Argyrosomus regius	Meagre	Ame
ARB	Ariosoma balearicum	Bandtooth conger	Ngjalë deti e baleareve

RLI	<i>Arnoglossus imperialis</i>	Imperial scaldfish	Gjuhëzë perandorake
